

VENDIM
Nr. 1012, datë 22.11.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËTËRORE TË MINISTRIT TË SHETËTIT PËR ÇËSHJTJET VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e fushave të përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, reformën e decentralizimit të qeverisjes dhe reformën administrativo-territoriale.

III. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, për realizimin e fushës së përgjegjësisë së tij, ushtron këto kompetenca:

1. Në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendon punën, ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

2. Propozon dhe/ose bashkërendon punën për hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore në fushën e luftës kundër korrupsionit.

3. Jep mendime dhe opinione të specializuara për projektaktet ligjore dhe aktet nënligjore me karakter normativ të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore, që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

4. Në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, është përgjegjës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit e të planit të veprimit në kuadër të kësaj strategjie, si dhe monitoron e raporton për progresin e zbatimit të këtyre dy dokumenteve të politikave shtetërore antikorrupsion.

5. Bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e organeve e të institucioneve shtetërore të pavarura, në qendër dhe në nivel vendor, për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe përfaqëson qeverinë në marrëdhëniet me organet kushtetuese, në kuadër të bashkërendimit të punës në këtë fushë.

6. Bashkërendon punën ndërmjet strukturave ndërminstrore/ndërsektoriale, në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit.

7. Përfaqëson politikën e qeverisë pranë mekanizmave dhe organizatave ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e luftës kundër korrupsionit.

8. Bashkërendon punën dhe mbështet veprimtaritë shtetërore dhe/ose të subjekteve të tjera për trajnimin, përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e organeve shtetërore dhe të administratës publike në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit.

9. Bashkërendon punën dhe mbështet veprimtaritë e marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe transparencës.

10. Bashkërendon punën për mbledhjen e informacioneve dhe të statistikave nga të gjitha institucionet shtetërore për praktikën korruptive dhe luftimin e tyre.

11. Ndërmerr nisma dhe aktivitete edukuese e sensibilizuese me karakter kombëtar për të parandaluar dhe eliminuar korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisjes.

12. Drejton, bashkërendon punën dhe ndjek në tërësi procesin e kryerjes së reformës administrativo-territoriale.

13. Bashkërendon punën dhe ndjek realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit e të qeverisjes vendore.

14. Harton dhe/ose bashkërendon punën për projektaktet ligjore e nënligjore në fushën e decentralizimit e të qeverisjes vendore.

15. Drejton dhe/ose bashkërendon punën ndërmjet strukturave të ngritura në kuadrin e marrëdhënieve ndërinstytucionale me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë.

16. Përfaqëson politikat e qeverisë në fushën e reformës së decentralizimit e të qeverisjes vendore pranë nismave dhe organizatave ndërkombëtare.

17. Kryen edhe funksione e veprimtari të tjera brenda fushës së përgjegjësisë, që i ngarkohen në përputhje me ligjin, marrëveshjet ndërkombëtare, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të Kryeministrit apo që nuk i janë ngarkuar specifikisht një organi apo institucioni tjetër shtetëror.

IV. Ngarkohet ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama